

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 14 KORRIK 2022

Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimet e tjera pa dyshim që do të jenë në fokus të këtij parlamenti edhe kur ne të mos jemi më pjesë e tij, sepse sfida më e madhe e ligjshmërisë ngelet kundërligjshmëria. Diferenca është se lufta nuk u takon vetëm organeve të dritësisë, lufta na takon edhe neve, lufta kundër krimit është sfidë edhe për ne. Në radhë të parë, është sfidë për mendësinë, pra për atë mendësi të gabuar, të rrënjosur thellë, si rrjedhojë e një kulture të mbrapshtë ndaj ligjit, e cila ushqen ngado dhe gjerësisht në çdo nivel.

Mendësia e të fortit, mendësia e të qenit i mbrojtur, mendësia e të qenit i atij apo i këtij, mendësia e të qenit juaji, është fiks mendësia për të cilën po flas, që e keni parë, vazhdoni ta shikoni, e shohim ne dhe na takon neve, të gjithëve bashkë, që të distancohem nga kjo lloj mendësie. Në radhë të parë, në konsolidim të asaj fryme që patëm apo që shprehëm kur votuam për reformën në drejtësi. Në radhë të dytë, ne si maxhorancë jemi shprehur se nuk duam t'i japim mbrojtje publike askujt që ka shkelur ligjin. Këtu duhet këmbëngulim.

Pas 6 vjetësh përpjekje, debate, diskutime, përplasje, sot, në fakt, ne i kishim këtu të gjithë kryesuesit e drejtësisë së re, besoj se është hera e parë në Kuvendin e Shqipërisë që bëhen të gjithë bashkë, në të njëjtën seancë plenare, për të raportuar për punën, që është zgjedhur secili të kryejë, por ata ishin bashkë edhe përpara nesh, përpara publikut, për të kuptuar drejt dhe në mënyrë të plotë bilancin e punëve të drejtësisë dhe protagonistëve të drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Qartësisht reforma në drejtësi na e paska dhënë këtë mundësi, dashur pa dashur, dhe si asnjëherë më parë dhe na detyron, mendoj unë, edhe ne të zgjedhurve të ndryshojmë qasjen edhe në diskutim, edhe në qëndrim, sepse kjo qasje detyrimisht duhet të jetë komplementare, vlerësimi duhet të jetë i tillë, duke shmangur tërësisht subjektivizmin apo interesat personale.

Drejtësia duhet të jetë objektive, e bazuar në ligj dhe në prova, ajo duhet të reflektojë integritet dhe sakaq edhe vlerësimet tona të shprehura në rezolutat që kemi sjellë sot për miratim të tilla duhet të jenë. Publiku ka nevojë të kuptojë, përtej përplasjeve që iniciohen shumë shpesh për kundërshti politike dhe për interesa politike, efektet e drejtësisë së re, sepse kjo është e vetmja mënyrë për ta zbatuar dhe respektuar ligjin me korrektesë dhe me drojë e natyrshme që vetë ligji të imponon. E thënë më thjeshtë, është e vetmja mënyrë për të luftuar mendësinë e gabuar që vjen nga kultura e ulët që ne kemi si shoqëri lidhur me respektimin e ligjit. Gjyqtarët dhe prokurorët marrin dhe japin vendime në emër të republikës, por sa të respektuar i ka bërë kjo dhe sa të respektuar janë ata sot?

Unë kam realisht shumë dyshime, sikundër më duhet të ndaj shumë sinqerisht, edhe me ish-kolegë magistratë, në këtë sallë dhe jashtë kësaj salle, me të gjithë ata që duan të bëhen magistratë dhe të kontribuojnë për drejtësinë dhe pushtetin e së drejtës për aksesin e barabartë të çdo qytetari të drejtësia, se për të rivendosur respektin ndaj ligjit, për të rivendosur respekt edhe ndaj figurës së tyre, ndaj kësaj republike parlamentare të themeluar mbi principin e ligjshmërisë, ata vetë duhet ta mbajnë dhe ta zhvillojnë këtë përgjegjësi, duke mos e parë të lidhur apo të limituar me kohën e mandatit, në të cilin janë zgjedhur të ushtrojnë detyrën, por me impenjimin serioz të gjithsecilit, që në respekt të vetes, në respekt të ligjit, në respekt të kësaj salle, ku qëndrojnë përfaqësues të popullit shqiptarë, të lënë gjurmë të qëndrueshme dhe të çojnë përpara një betejë, e cila po bëhet gjithnjë e më sfiduese jo vetëm për ne, por për këdo.

Sot e gjithë bota diskuton për prirjet e reja të krimit, për shembull, për nevojën e vendosjes ose imponimit të instrumenteve të reja ligjore, sot kur diskutohet juridiksioni edhe për kompetencën, që për krimin e organizuar është vështirë që të mund ta orientojmë sipas lëndës dhe sipas territorit, sepse krimi i organizuar më shumë po vepron online sesa offline, pra në një kohë që ndodhin këto diskutime, neve na duhet të bëjmë kapërcimin e madh, që shënon ndarjen përfundimtare nga historitë e vjetra dhe të turpshme të drejtësisë, dhe na jep të gjithëve bashkë ndjesinë e të vënit në veprim të një pushteti të fortë dhe të pavarur, që duhet të jetë në shërbim të publikut dhe vetëm të publikut. Unë i kam dëgjuar me vëmendje të gjithë

drejtuesit e institucioneve, edhe kur kanë ardhur në komisionin parlamentar dhe sigurisht që nuk mund ta mohojë askush që ka rezultate të mira, si dhe ka diferencë me atë çfarë po kërkohet të vendoset në sistem.

Po e nis me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, organin disiplinor të prokurorëve dhe gjyqtarëve. A kanë besim qytetarët te ky inspektorat? Po, kjo rezulton edhe nga numri i ankesave, kategorizimi i tyre, ku vendin e parë e zënë qytetarët me 4700 ankesa, tha inspektori i Përgjithshëm në fjalën e tij. Disiplinimi po ndodh nëpërmjet ushtrimit të kësaj detyre, këtu dua të tërheq vëmendjen e gjithsecilit, nga magjistratët, prokurorët dhe gjyqtarët, pra nga ndjekja korrekte e ligjit dhe jo nëpërmjet luftërave që më parë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë i nixte politika dhe betejat ndodhnin në mes të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me buratinët, që politika kujdesej t'i kishte aty, gati në çdo kohë për veprim.

Kjo është arritja e parë dhe e rëndësishme, sepse nuk është kaq e thjeshtë të vendosësh një sjellje të re. Nuk po flas këtu posaçërisht për punën e organit, por për të gjitha subjektet, që e vënë në lëvizje ILD-në, të cilat do të duhet të mësohen t'i drejtohen këtij organi me seriozitet, me fakte dhe me prova, jo nga poltroni, jo nga foltorja, jo nga ekrani, jo me letra shpifëse, që kërkojnë të denigrojnë punën e pakompromis të çdo magjistrati. Për sa më takon, e kam vlerësuar përfshirjen e ILD-së në Rrjetin Europian të Shërbimeve të Inspektiveve të Drejtësisë, sepse besoj se kjo do ta ndihmojë ILD-në të performojë më mirë dhe të themelojë një trupë inspektorësh karriere, profesionistë të mirë të ligjit, por jo vetëm kaq, edhe shques të mirë të shkeljeve që ndodhin gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e magjistratëve.

Sfida për këtë organ nuk duket e vogël në kushtet e burimeve njerëzore të kufizuara, por, ama, qasja duket e duhur, duket e kujdesshme dhe aspak paragjykuese, pavarësisht se presioni është shumë i lartë dhe nuk ka njeri këtu që të mos e marrë me mend se sa presion ka. Prokurori i Përgjithshëm: ka rritje të hetimeve proaktive, edhe të përdorimit të mjeteve, që i quajmë moderne, në njëfarë mënyrë, të kërkimit të provës, veçanërisht në veprat penale si korrupsioni, pastrimi i parave, shpërdorimi i detyrës, evazioni fiskal. Këtë tha Prokurori i Përgjithshëm dhe kjo ka ndodhur në një kohë kur kapacitetet thuhet janë përgjysmuar. Me sa duket, pavarësia e

prokurorëve, njohja e saj jo vetëm në seancë, ku Prokurori merr pjesë, por edhe në ligj, ka qenë vendimtare për këtë rezultat; edhe kjo është pasojë e ndryshimeve që solli reforma në drejtësi.

Lufta ndaj veprave penale të dhunës në familje është ashpërsuar edhe në raport me përhapjen e kësaj veprë. Pa dyshim, kjo është një sjellje e duhur dhe duhet përshëndetur, por unë do t'u tërhiqja vëmendjen gjykatave të shkallës së dytë, sepse shpeshherë këto gjykata u japin vetes atributin e atyre që duhet të falin dhe ky atribut shkon përtej ligjit, sepse ato do të duhet të kufizohen, siç thotë ligji, te provat dhe te rëndësia e faktit dhe, sigurisht, duhet t'i përshtaten dhe nevojës që kemi ne si shoqëri për ta luftuar, për ta denoncuar dhunën në familje. Krimi zgjedhor është goditur shumë më shumë se më parë dhe kjo vlen të vlerësohet, vlen për ne, në radhë të parë, si të zgjedhur, vlen për zgjedhësit tanë, sepse edhe neve na duhet të ndryshojmë sjellje, në mënyrë që të respektojmë proceset zgjedhore.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në gjykimin tim, do të duhen të kenë një qasje më intuitive ndaj sistemit, trupave të ndryshme që administrojnë, duke shprehur më shumë profesionalizëm në administrimin dhe mosmbajtjen pa fund të problematikave që ka sistemi, duke qenë edhe më unitarë në funksion të interesave që shpreh Kushtetuta për pushtetin gjyqësor dhe larg suazës së interesave për të cilat ndodh që janë mbështetur rrugës dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë edhe duke qenë brenda trupave, sepse jo gjithmonë këto interesa përkojnë me atë që e ka emrin profesionist, me atë që e ka emrin profesionist dhe me integritet. Jo më larg se dje patëm rastin ta konstatojmë një diferencë të tillë tek ata që përfaqësojnë avokatët në këto trupa, edhe te përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Shërbimi i të dhënit drejtësi dhe i të kontribuarit në sigurimin e dhënies së drejtësisë sipas ligjit, nuk është shërbim që i koncesionohet dikujt sipas shijeve dhe gustove. SPAK-u ka arritje në punën e tij, këtë e shprehu prokurori i SPAK-ut në fjalën e tij, por ama, kur jemi shprehur kundër, kur kemi rezervuar kritika publike, këtë e kemi bërë të qartë, se ne jemi kundër atyre që bëjnë ekuilibristin në sistem, ne jemi kundër apatikëve, ne jemi kundër selektimeve, sepse, nëse drejtësinë e shënjon barazia si shenjë, kjo do të thotë që asgjë nuk duhet të harrohet dhe asgjë nuk duhet të ketë justifikim kohën.

Pra, aktiviteti duhet të ngelet fjala kyçe për këto organe në veçanti. Të shërbyerit në drejtësi, mos harroni, është privilegj në emër të shtetit dhe pikërisht se është privilegj do të duhet që i gjithë sistemi ta ndiejë veten në kërkesën e llogarisë dhe të përgjegjësisë. Ju faleminderit!